

GEORG TRAKL

POEZI



Titulli: Poezi

Titulli në origjinal: Die Dichtungen

Autori: Georg Trakl

Përktheu nga gjermanishtja: Arb Elo

Përkujdesja grafike: Erzen Pashaj

Në kopertinë: Fragment nga *Peizazh me pemë të larta (1900-1902)*,

Leon Spilliaert

traduki^T

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar, ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Evropë, Integrim dhe çështje të Jashtme e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës së Gjermanisë, Fondacioni Kulturor i Zvicrës Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit JAK, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor Liechtenstein, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informimit e Republikës së Serbisë dhe Fondacioni S. Fischer

© of the translation: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI

Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura me ligj dhe të rezervuara.

Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesshme, është i ndaluar.

Nuk mund të kopjohet asnjë pjesë teksti pa lejen dhe miratimin paraprak të Botimeve Pika pa sipërfaqe, i cili është mbajtësi i vetëm i të drejtës së botimit dhe shpërndarjes së tij, përveç rasteve kur kjo e drejtë jepet qartas nga ligji.

Botimi i parë: Pika pa sipërfaqe, 2016

ISBN: 978-9928-185-31-0

Për kontakt të mëtejshëm:

Cel.: +355 672812743

e-mail: pika.pa.siperfaqe@gmail.com

www.pikapasiperfaqe.com

Tiranë, 2016

Shtypur në shtypshkronjën West Print

GEORG TRAKL

POEZI

(botim dygjuhësh)

Përktheu nga origjinali:

ARB ELO



Shënim biografik


Georg Trakl u lind më 3 shkurt, 1887, në Salzburg, Austri, i katërti nga gjashtë fëmijë të tregtarit të hekurishteve Tobias Trakl dhe gruas së tij (të dytë) Maria. Fëmijërinë dhe rininë i kalon në qytetin e lindjes. Në gjimnaz nuk e kalon klasën e gjashtë, duke e shtyrë të atin të vendosë për një karrierë në farmaci. Pasi mbaron një kurs trevjeçar si praktikant, aktivizohet në shërbimin farmaceutik ushtarak. Nga maji 1912 deri në gusht të 1914-ës jeton më së shumti në Innsbruck, gjysmën e parë të vitit si “aksesist medikamentesh” në spitalin e garnizonit. Meqenëse ndihet i dobët për të përballuar mundimet që kërkon shërbimi, kalon në rezervë. Në janar 1913 punësohet si shkruer në një ministri në Vjenë; pas tri ditësh e lë punën dhe kthehet në Innsbruck. Provon edhe dy herë – në korrik dhe në fund të vjeshtës së po atij viti – të vendoset në Vjenë. Më kot. Kthehet vazhdimisht në Tirol, si endacak. Këtu gjen te Ludwig von Ficker, në Myhlau, botuesin e revistës kulturore *Der Brenner*, strehë dhe mbrojtje nga hallet e botës, duke qëndruar aty me ndërprerje të shkurtra gjer në fillim të luftës. Po atë vit (1913) e kalon pranverën në Hohenburg, në Igls dhe shkurtimisht në Salzburg; udhëtime të shkurtra e të rastësishme, të mundësuar nga miqtë, e çojnë në Venecia, Berlin dhe liqenin e Gardës.

Në fund të gushtit 1914 dërgohet në detyrën e tij të vjetër (me gradën toger) si aksesist medikamentesh në një kolonë sanitare të Insbrukut në Galici, në front. Pas betejës së Grodekut i duhet të kujdeset, i vetëm në një hambar, për nëntëdhjetë të plagosur rëndë, pa mundur t'u ndihë. Në dëshpërim të thellë, kërkon të vrasë veten; ia heqin armën shokët. Qetësohet përsëri dhe vijon shërbimin, pa shenja të jashtme shqetësimi. Disa javë më vonë komandohet papritur të shkojë në Krakov. Beson se e kanë dërguar të punojë si farmacist. Me tmerr i duhet të konstatojë se e kanë shpënë atje për ta mbajtur nën mbikqyrje në pavijonin psikiatrik të spitalit. Aty edhe vdes, 27 vjeç, natën mes 3 dhe 4 nëntorit 1914, me gjasë nga një dozë e madhe helmi, që e ka marrë më datë 2 nëntor në darkë; ka dyshime lidhur me qëllimshmërinë e vetëhelmimit, meqë Trakli ishte përdorues i rregullt droge. Në varrimin e tij nuk merr pjesë askush, përveç minatorit Matthias Roth, djalë i ri e shok besnik. Në vjeshtën e vitit 1925 eshtrat e poetit sillen në Tirol, ku prehen, sot e kësaj dite, në varrezën e bashkisë Myhlau, Insbruk.

PJESA E PARË

ERSTER TEIL

QYTETI I BUKUR



DIE SCHÖNE STADT

Verfall

Am Abend, wenn die Glocken Frieden läuten,
Folg ich der Vögel wundervollen Flügen,
Die lang geschart, gleich frommen Pilgerzügen,
Entschwinden in den herbstlich klaren Weiten.

Hinwandelnd durch den dämmervollen Garten
Träum ich nach ihren helleren Geschicken
Und fühl der Stunden Weiser kaum mehr rücken.
So folg ich über Wolken ihren Fahrten.

Da macht ein Hauch mich von Verfall erzittern.
Die Amsel klagt in den entlaubten Zweigen.
Es schwankt der rote Wein an rostigen Gittern,

Indes wie blasser Kinder Todesreigen
Um dunkle Brunnenränder, die verwittern,
Im Wind sich fröstelnd blaue A stern neigen.

Rrënim

Në mbrëmje, kur nisin dhe bien paqe kambanat,
Ndjek unë fluturimet mahnitëse të zogjve, që varg
Shkojnë, si karvanë pelegrinësh të devotshëm larg,
Zhduken hapësirave vjeshtore, t'kthjellta e t'paana.

E s'ua ndiej orëve akrepin të lëvizë një grimë
Tek endem përmes kopshtit plot me mugëtirë
Ëndërroj 'dhe ca për fatin e tyre më të ndrirë
Ashtu e ndjek përmbi re unë të tyrin rrugëtim.

Pastaj një puhi rrënimi më çon një drithërimë.
Klith thirravaj mëllenja nëpër degët pa fletë.
Tundet hardhia anë të ndryshkurës thurimë.

Ndërkaq si valle vdekje fëmijësh të zbehtë
Përreth buzësh t'errëta pusi, që moti i grin,
Luleyje blu ngrijnë n'erë tek përkulen lehtë.

Musik im Mirabell

Ein Brunnen singt. Die Wolken stehn
Im klaren Blau, die weißen, zarten.
Bedächtig stille Menschen gehn
Am Abend durch den alten Garten.

Der Ahnen Marmor ist ergraut.
Ein Vogelzug streift in die Weiten.
Ein Faun mit toten Augen schaut
Nach Schatten, die ins Dunkel gleiten.

Das Laub fällt rot vom alten Baum
Und kreist herein durchs offene Fenster.
Ein Feuerschein glüht auf im Raum
Und malet trübe Angstgespenster.

Ein weißer Fremdling tritt ins Haus.
Ein Hund stürzt durch verfallene Gänge.
Die Magd löscht eine Lampe aus,
Das Ohr hört nachts Sonatenklänge.

Muzikë në Mirabell

Një burim këndon. Qëndrojnë retë
T'bardha, t'brishta blusë së qëruar
Në mbrëmje njerëz i shkojnë qetë
Të vjetrit kopsht përmes menduar.

Mermeri i të parëve është bërë gri.
Një varg zogjsh përvijohet n'hapësira.
Një faun me sy të vdekur sodit tek rri
Hije, që rrëshqasin përkah errësira.

Kuq bie gjethnaja nga e vjetra pemë
Hyn prej dritares së hapur përqark vrik
Një ndrimë zjarri n'odë skuq edhe më
Dhe pikturon turbullt fantazma frike.

Në shtëpi hyn një bardhosh i huaj.
Kthinash t'rrënuara rrëzohet një qen.
Një llambë shërbëtorja nis ta shuaj',
Tinguj sonate zë veshi kur nata vjen.

Frauensegen

Schreitest unter deinen Frau'n
Und du lächelst oft beklommen:
Sind so bange Tage kommen.
Weiß verblüht der Mohn am Zaun.

Wie dein Leib so schön geschwellt
Golden reift der Wein am Hügel.
Ferne glänzt des Weihers Spiegel
Und die Sense klirrt im Feld.

In den Büschen rollt der Tau,
Rot die Blätter niederfließen.
Seine liebe Frau zu grüßen
Naht ein Mohr dir braun und rauh.

Bekim grash

Shpesh tek shkon me gra të tua
Buzëqesh ti prej ankthit zbehur:
Ditë të frikshme ia kanë behur.
Gardhit fishket bardhë lulëkuqja.

Siç fort bukur kurmi t'u mbush
I artë piqet rrushi në kodrinë.
Tej e pellgut pasqyrë shndrin
Dhe kosa tringëllin në fushë.

Nëpër kaçube vesa rrokulliset,
Kuç përposh po rrjedhin fletët.
Gruan e vet t'dashur t'ngjatjetë
Kaf, i vrazhdë një arap t'avitet.

Die schöne Stadt

Alte Plätze sonnig schweigen.
Tief in Blau und Gold versponnen
Traumhaft hasten sanfte Nonnen
Unter schwüler Buchen Schweigen.

Aus den braun erhellten Kirchen
Schaun des Todes reine Bilder,
Großer Fürsten schöne Schilder.
Kronen schimmern in den Kirchen.

Rösser tauchen aus dem Brunnen.
Blütenkrallen drohn aus Bäumen.
Knaben spielen wirr von Träumen
Abends leise dort am Brunnen.

Mädchen stehen an den Toren,
Schauen scheu ins farbige Leben.
Ihre feuchten Lippen beben
Und sie warten an den Toren.

Zitternd flattern Glockenklänge,
Marschtakt hallt und Wacherufen.
Fremde lauschen auf den Stufen.
Hoch im Blau sind Orgelklänge.

Qyteti i bukur

Sheshe të vjetra diellët n'heshtje.
Thellë në blu e në t'artë të endur
Murgesha t'brishta nxitojnë ëndërrt
Nën të zagusht ahesh heshtje.

Prej në t'kafenjtë të ndrirash kisha
Këqyrin të dekës të dëlira pamje,
Stema t'bukura princash me nam.
Kurora po vezullojnë ndër kisha.

Dorinj po dalin jashtë ç'prej kroit.
Kthetra gonxhesh pemësh kanosen.
Çunakë t'pështjellë nga ëndrra lozin
Në mbrëmje lehtë aty ndanë kroit.

Vajzat po rrinë përndanë portave,
Ndrojtur këqyrin n'jetën me ngjyra.
U tranden të njomështat buzë atyre
E rrinë e presin ato ndanë portave.

Dridhur flatrojnë t'kambanës tinguj,
Jehon thirrme rojash e takt marshesh.
Mbi shkallina të huaj po mbajnë vesh.
Lart nëpër blu janë t'organos tinguj.

Helle Instrumente singen.
Durch der Gärten Blätterrahmen
Schwirrt das Lachen schöner Damen.
Leise junge Mütter singen.

Heimlich haucht an blumigen Fenstern
Duft von Weihrauch, Teer und Flieder.
Silbern flimmern müde Lider
Durch die Blumen an den Fenstern.

Instrumenta të kthjellët këndojnë.
Mes kopshtijesh me gjethe veshur
Zonjash të bukura zien e qeshura.
Nëna të reja nën zë po këndojnë.

Fshehtas fryn në të lulëtat dritare
Aromë temjan, jargavan dhe serë.
Të lodhura po farfurojnë argjendtë
Qepalla përmes luleve në dritare.